

PROCES – VERBAL

“Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim”

Objekti i Prokurimit: “Rindërtimi 35 banesave individuale dhe mobilimi i tyre në territorin e Bashkisë Mirditë”, ne kuadër te rindertimit.

Vlera e fondit limit: 122,579,674.45 leke pa tvsh.

Në bazë të Aktit Normativ Nr. 9, Datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me ligjin 97/2019, VKM 199/2020 “Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit për punët, shërbimet dhe mallrat, kriteret e vlerësimit të ofertës fituese, kushtet e marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për rindërtimin” nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, Fondi Shqiptar i ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 4;*

c. *Sigurim oferte sipas Shtojcës 5 ne fazen e dyte;*

ç. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*

d. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 8;*

dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojces 11;*

e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 12;*

f. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve/makinerive sipas Shtojcës 13;*

g. *Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces në kuadër të rindërtimit, sipas Shtojcës 14;*

gj. *Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industriale sipas aktit normative sipas Shtojcës 15;*

h. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen ne VKM 199/2020 “Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit për punët, shërbimet dhe mallrat, kriteret e vlerësimit të ofertës fituese, kushtet e marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për rindërtimin”.

2.1 Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme, sipas shtojcës 10 te DST.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019, 2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës në procedurën e prokurimit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2018, 2019, 2020, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

Argumentimi për kriterin 2.2: Këto kritere janë vendosur në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, bazuar në neni 42 të Aktit Normativ 9/2019, nenin 77, pika 3, e LPP dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” Autoriteti në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të

njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.“

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2018, 2019, 2020, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nëneni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

2.3.1.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllorarit të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

***Pika 2.3.1/a,** plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:
 - Kontratën/at e Sipërmarrjes
 - Situacion punimesh
 - Fature tatimore për çdo situacion punimesh
 - Akt kolaudimi;

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit;

Per kontratat e realizuara si Nenkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- Kontratë baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe
- Miratimin zyrtar si nenkontraktor nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 40 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përnën një nivel të mjaftueshëm përvoje duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Licenca profesionale të operatorit për realizimin e objektit të kontratës:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:
 - N.P – 1.A Punime gërmimi në tokë.
 - N.P – 3.C Ndertime civile e Industriale.
 - N.P – 7.A Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje
 - N.P – 11.A Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
 - N.P – 12.A Punime të inxhinierisë së mjedisit.
- Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:
 - N S – 3.A Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre.
 - N S – 4.B Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese.
 - N.S – 8.A Ndertime parafabrikat me beton te armuar, struktura metalike dhe Druri.
 - N.S – 14A Impiante te brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV
 - N.S – 18A Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjisë, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Kategoritë janë kërkuar bazuar në listen e zërave dhe vlerat e punimeve. Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zerat e punimeve të ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.3.3 Staf i kryesor i inxhinierëve të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit është; Shoqëria të ketë në stafin drejtues të punësuar dhe të regjistruar:

- 1 (nje) Drejtues Projekti (Inxhinier Ndertimi) me 15 vite eksperience pune ne Ndertime Civile .
- 2 (dy) Inxhinier Ndërtimi me 10 vite eksperience pune ne Ndertime Civile
- 1 (nje) Arkitekt me 10 vite eksperience pune ne Ndertime Civile
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik me 10 vite eksperience pune
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik me 5 vite eksperience pune.
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet me 5 vite eksperience pune.
- 1 (një) Inxhinier Elektrik me 5 vite eksperience pune.
- 1 (nje) Inspektor Cilesie me background Inxhinierik me 5 vite eksperience pune si Inspektor Cilesie
- 1 (nje) Inspektor te sigurimit dhe Shendetit ne pune (HSE)
- 1 (një) Inxhinier mjedisi

Si dëshmi për stafin e mësipërm të paraqiten dokumentet si më poshtë:

-Diplome /Certifikate

-CV

Shënim: Në fazën e dytë operatori ekonomik duhet të deklarojë me shkrim se inxhinieret e kerkuar në pikën 2.3.3 janë të paangazhuar në kontrata të tjera.

Autoriteti pergjegjes rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merrem masa për ndërprerjen e kontratës

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, projektin, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, elektrik dhe hidroteknik etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin për ndërtimin e banesave individuale në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Duke ju referuar numrit të banesave dhe natyrës specifike ku përfshihen banesa sipas projekteve model (1+1, 1+2, 1+3) me metodologji tradicionale, është shumë e rëndësishme kapaciteti dhe përvoja e mëparshme në punë e stafit teknik të inxhinierëve. Përcaktimi i viteve të eksperiencës në punë nuk ka të bëjë me vitet e punës për marrjen e licencës, por është tregues i aftësive profesionale, organizative, reputacionit, besueshmërisë dhe ndikon në efikasitetin dhe zbatimin e kontratës. Për sa i përket numri të inspektorëve të cilësisë, të sigurimit dhe Shëndetit autoriteti duke patur parasysh se objekti i kontratës shtrihet në territorin e bashkisë Mirdite dhe numrin e banesave individuale, por jo vetëm e bëjnë të domosdoshëm prezencën e inspektorëve të cilësisë gjatë zbatimit të kontratës, të inspektorit të sigurisë dhe shëndetit në punë. Sigurimi i shëndetit në punë kërkon punonjës të kualifikuar me qëllim që të kontrollojnë zbatimin e rregullave të sigurimit, marrjen e masave gjatë zbatimit të kontratës në të gjithë objektet me vendodhje të ndryshme në zonat e dëmtuara nga tërmeti i nëntorit 2019. Lidhur me inxhinierin e mjedisit duke mbajtur parasysh prodhimin e mbetjeve urbane por jo vetëm gjatë zbatimit të kontratës, prania e inxhinierit të mjedisit është i nevojshëm me qëllim marrjen e masave për mbrojtjen e mjedisit. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje

të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

2.3.4 Fuqia punëtore e operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit të jetë minimalisht 90 persona të punësuar për periudhën mars 2021 – maj 2021. Si dëshmi për fuqinë punëtore do të dorëzohen dokumentet si më poshtë;

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore për periudhën mars 2021 – maj 2021 shoqëruar me listëpagesat sipas formatit që kërkohet nga legjislacionin tatimor.

Argumentimi: Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës etj.. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje **mars 2021 – maj 2021**, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listëpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

Numri i punonjësve nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore

2.3.5 Mjetet dhe pajisjet teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës. Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike do të paraqiten këto dokumente:

- | | |
|--|--------|
| 1. Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 10 - 20 ton – | 4 copë |
| 2. Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 5 - 10 ton – | 2 copë |
| 3. Kamion me kapacitet mbajtes 10-20 ton me vinc | 2 cope |
| 4. Eskavator me zinxhire – | 2 cope |
| 5. Eskavator me goma – | 2 cope |
| 6. Bob CAT (minifadrome) | 1 cope |



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

7. Minieskavatore –	2 cope
8. Pirun ngrites teleskopik -	1 cope
9. Saldatrice -	6 cope
10. Kompresor Ajri -	2 cope
11. Autobetoniere –	3 copë
12. Auto Pompe betoni -	2 cope
13. Rrul hekur hekur (me kapacitet deri ne 5 ton)	2 cope
14. Autobot uji –	1 copë
15. Skeleri –	2000 m2
16. Gjenerator –	2 cope

a) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatori, duhet të paraqiten:

-kontratat e shitblerjes ose kontratat e qirasë / kontrate furnizimi.

b) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet:

- certifikatën e pronësisë;

- leja e qarkullimit;

ndërsa për mjete të marra me qira, duhet të paraqitet:

-kontrata e qirasë.

-leja e qarkullimit

c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet:

- kontrata e blerjes apo çdoganimit dhe faturat tatimore përkatëse,

ndërsa për mjete të marra me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë.

Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera. Mjetet te cilat rezultojne te angazhuara ne kontrata te tjera afati i zbatimit te cilave shtrihet pergjate afatit te kontrates objekt i prokurimit jane shkak skualifikimi. Autoriteti pergjegjes gezon te drejten te verifikojte dhe kontrolloje disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri dhe lloji i makinerive dhe paisjeve është vendosur duke ju referuar punimeve sipas standardeve të miratuara për banesat individuale, orëve të punës, zërave të punimeve, sipas grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifíkimeve teknik që duhen për të përmbushur kontratën. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin

kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit përgjegjes për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Numri i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme si me poshte:

- ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) ose ekuivalent e vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) ose ekuivalent e vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose ekuivalent e vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Nese ofertuesi do të paraqitet si bashkim operatorësh, certifikatat duhet të jene në përputhje me punimet e marra persiper.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët të kryejnë punimet dhe realizojnë objektin e kontratës me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, të mjedisit dhe shëndeteti të sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit përgjegjes për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.